

nr. prot. 4  
dt. 29.12.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 4, datë 13.12.2017

P Ë R

**MIRATIMIN E LEJES, “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,  
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC-ET “SHËNGJON 1”;  
“SHËNGJON 2”; “SHËNGJON 3”; ME VENDNDODHJE NË FSHATIN  
SHËNGJIN, NJËSIA ADMINISTRATIVE FAN, BASHKIA MIRDITË,  
QARKU LEZHË**

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujq”, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë “Ediani”, sh.p.k., për HEC-et “Shëngjon 1”, “Shëngjon 2”, “Shëngjon 3”, me vendndodhje në fshatin Shëngjin, njësia administrative Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA

